



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KOMUNA E LIPJANIT**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**



**REPUBLIKA KOSOVA**  
**OPSTINA LIPJAN**  
**MUNICIPALITY OF LIPJAN**

---

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Datë:	05.05.2026
Referencë:	ZR
Për:	Imri AHMETI, Kryetari Komunës
Nga:	Imri Semetishti, Drejtor i DPUMM
Kopje:	Diamant Bytyçi, Nënkyetar i Komunës Avni Jashari, Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës
Lënda:	RAPORTI MUJOR I PUNËS – PRILL - 2026

Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, bazuar në detyrat e përcaktuara sipas Planit Vjetor të Punës për vitin 2026, ju dorëzon:

**RAPORTIN MUJOR**  
**TË PUNËS PËR PERIUDHËN RAPORTUESE 01.04.2026-30.04.2026**  
**(PRILL – 2026)**

## PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periudhës raportuese DPUMM- ka zhvilluar aktivitetet themelore si vijon:

Gjatë kësaj periudhe DPUMM ka trajtuar disa prej lëndëve të pranuar dhe kërkesave të bartura. Gjatë muajit prill 2026-janë pranuar gjithsejtë 33<sup>1</sup>-kërkesa të natyrave të ndryshme, kurse të bartura nga muaji paraprak kanë qenë 15 lëndë, në total 48 lëndë për shqyrtim. Prej tyre janë trajtuar gjithsejtë 33 kërkesa, 21 të miratuara dhe 12 të refuzuara. Për shqyrtim në muajin vijues (maj 2026) barten 15 lëndë të natyrave të ndryshme.

Statusi i trajtimit të lëndëve të pranuar dhe atyre të bartura është prezantuar në pjesën tabelare.

Në kuadër të aktiviteteve të tjera DPUMM ka kryer edhe aktivitete të tjera.

Në fushën e shqyrtimit të kërkesave është vazhduar me intensifikimin e angazhimeve për shqyrtimin e tyre brenda afateve ligjore.

Pjesë e veçantë e shqyrtimit të kërkesave është edhe procedura e lëshimit të konkluzioneve për pagesen e taksave sipas kategorive të caktuara. Lidhur me këte janë lëshuar 11 konkluzione për pagesen e taksave. Prej tyre 3 konkluzione për leje ndërtimi, 1 për leje mjedisore komunale, 3 për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimi dhe 4 për certifikatë legalizimi.

Po, ashtu DPUMM ka përgatitur dhe adresuar te palët ftesa për plotësimin e dokumentacionit. Në kuadër të kësaj është lëshuar 1 ftesë për kompletim të lëndës. Brenda muajit prill është pranuar një kërkesë për plotësimin e lëndës. Edhe gjatë këtij muaji kishte mjaft kërkesa të drejtpërdrejta (informative) lidhur me ndryshimin/plotësimin e HZK<sup>2</sup>.

Aktivitete të tjera janë kryer edhe si:

Janë proceduar administrativisht 4 kërkesa për kryerjen e pagesave sipas detyrimeve të arritura.

Është në zbatim e sipër programi për regjistrimin e adresave zyrtare. Procesi mbikëqyret drejtpërdrejt nga DPUMM. Gjatë muajit prill 2026-janë regjistruar 204 adresa në sistemin e adresave dhe po ashtu janë regjistruar 348 njësi banimi- kryesisht brenda zones urbane të qytetit.

Është plotësuar Pytësori për procedura për Leje ndërtimi për infrastrukturen e telekomunikacionit. Pyetësori sipas kërkesës iu ka dorëzuar Këshillit për bashkëpunim regjionaol të Bashkimit Evropian.

Lidhur me aktivitetet për PZHK, gjatë muajit prill është trajtuar rishikimi i Planit të Veprimit, pjesa për profilin e PZHK-së dhe plani i veprimit.

### **Aktivitetet themelore për muajin vijues:**

- *Shqyrtimi i të gjitha kërkesave të bartura;*
- *Fillimi i zbatimit të vendimeve të miratuara në seancen e Kuvendit të Komunës të mbajtur me 24.03.2026.*
- *Vazhdimi i punimeve në draft PZHK.*

---

<sup>1</sup> Është pranuar edhe 1 kërkesë për plotësim dokumentacioni bazuar në kërkesat e parashtruara paraprakisht.

<sup>2</sup> Këto kërkesa duhet të trajtohen në procesin e ndryshim/plotësimit të HZK-së.

## STATISTIKAT

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga palët

**Tabela 1.**

Nr.	Llojet e kërkesave	Të pranuar	Nga periudha e kaluar	Të miratura	Pushim procedure -pezullim	Të refuzuar	Të bartura në sektor të tjerë	Në proces (pritje)
1.	Kushte ndërtimore	5	4	2		4		3 <sup>3</sup>
2.	Leje ndërtimi	1	4	3				2
3.	Informacione urbane	4	1	2		1		2
4.	Certifikatë legalizimi /Leje Legalizimi	7	4	5				6
5.	Legalizimi/ Në listë të pritjes							
6.	Bashkim/ndarje e parcelave	2				2		
7.	Kërkesë për LMK		1	1				
8.	QRTK- sqarim	1		1				
9.	MMPHI – ankese	1				1		
10.	Ndriçim publik UNDP	1		1				
10.	Pëlqim për solar në ndërtesë	1		1				
11.	Ndërrimi i dest. të tokës	1				1		
12.	Plotësim i K. Ndërtim.	1		1				
13.	Vazhdim i L.Ndërtimit	1						1
14.	MMPH – pëlq.mjed.	2		1		1		
15.	Prokurimi - dokumente	1		1				
16.	Ankesë	1						1
17.	KEDS- vendosje tende	1				1		
18.	Korrigjim i KN	1		1				
19.	Riemertim rruge		1			1		
20.	Pyetsori – L.Ndërtimi <sup>4</sup>	1		1				
	Gjithsejtë:	33	15	21		12		15

*Sipërfaqja tokësore për ndërtim, sipërfaqja e ndërtesave dhe destinimi*

**Tabela 2.**

Nr.	Kategoria e ndërtimit	Sipërf. Tokës – m2	Sip.ndëtesës- m2	Destinimi	Vendi
1.	II	2152	Bodrum-895.5 Afarist-773.8 Banim-3380.2 Gjithsejtë-5052.5	NLN	Lipjan
2.	II	Një lamelë në	Bodrum-596.12	NLB	Lipjan

<sup>3</sup> Për një kërkesë për Kushte ndërtimi është zgatur afati i shqyrtimit për 30 ditë të tjera.

<sup>4</sup> Është plotësuar Pyetsori për procedura për Leje ndërtimi për infrastrukturen e telekomunikacionit.

		parcelen e përbashkët me lamelat tjera	Afarist-242.05 Banim-4111.44 Gjithsejtë-5294.48		
3.	II	3805	Bodrum-1988.5 Afarist-1505.5 Banim-4217.9 Gjithsejtë-7711.9	NLB	Lipjan
4.	II	619	510.22	Shtëpi	Lipjan
	Gjithsejtë	6576	18568.8		

Gjatë muajit prill nuk është dhënë ndonjë leje ndërtimi vetëm për qëllime afariste. Tri leje janë dhënë për ndërtime të larta banesore të kombinuara me afarizëm (NLB) dhe një leje vetëm për banim (shtëpi).

### **Buxheti:**

Gjatë muajit prill 2026 të hyrat nga kategoritë e ndryshme nga fusha urbane janë realizuar shumat si në vijim:

- Të hyrat për leje ndërtimore janë realizuar në shumë prej:.....61,256.18€
- Të hyrat për ndërrimin e destinimit të tokës në shumë prej: .....4,876.00€
- Të hyrat për leje mjedisore komunale janë realizuar në shumë prej.....2,470.29€
- Të hyrat për legalizimin e ndërtesave pa leje janë realizuar në shumë prej:.....3,176.18€
- Të hyrat për Leje rrënimi janë realizuar në shumë prej .....00€

Shuma totale e të hyrave: .....71,778.65€

*Të dhënat lidhur me të hyrat për muajin prill 2026 janë pranuar nga sektori i financave në kuadër të Drejtoratit përkatës të Komunës së Lipjanit.*

Lidhur me shpenzimet kemi proceduar me pagesa për kryerjen e detyrimeve të maturuara për muajin prill 2026. Mjetet e planifikuara për shpenzim janë nga kategoria ekonomike “Mallra dhe shërbime”.

### **DISKUTIME PUBLIKE:**

Gjatë prill 2026 nuk kemi pasur ndonjë diskutim publik.